

**AKT THEMELI
MI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“HAK Food ” shpk.**

Në Tiranë, sot më datë 02.12.2022, ne të poshteshënuarit:

Bekim Darsi, e datëlindjes 06.12.1989, lindur ne Fshat Kukës,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal I91206086V:

Atnan Spahiu e datëlindjes 19.04.1991, lindur ne kolesjan Kukës,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal J10419079I:

me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, “**HAK Food ” shpk.**

Neni 1

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin“**HAK Food” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria “**HAK Food” shpk** e ka seline në adresë:”Rruga Butrinti Nr 39,Valias,Kamez Tirane“dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4



Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine “**HAK Food” shpk** është “Import-Eksport te produkteve ushqimore me origjine bimore dhe shtazore,akullore,produkte mishi,bulmeti dhe nenprodukte te tyre,pije alkolike dhe produkte te ndryshme bujqesore.Tregetim te mallrave te ndryshme ushqimore,te mishit,akullores,bulmeti etj.Magazinimin dhe ruajtjen e produkteve ushqimore”.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.



Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 2(dy) kuota , te cilat zotërohen si më poshtë:

Bekim Darsi, e datëlindjes 06.12.1989, lindur ne Fshat Kukës,identifikuar me dokument identifikimi,karte identiteti me numër personal I91206086V, zoteron 1(nje) kuote ose 60 % te kapitalit te shoqërisë.

Atnan Spahiu e datëlindjes 19.04.1991, lindur ne kolesjan Kukës,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal J10419079I zoteron 1(nje) kuote ose 40 % te kapitalit te shoqërisë.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;



h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë "**HAK Food**" shpk është: Bekim Darsi, e datëlindjes 06.12.1989, lindur ne Fshat Kukes,identifikuar me dokument identifikimi:karte identiteti me numër personal I91206086V.Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emerimit eshte data 02.12.2022 dhe data e mbarimit te afatit te administratorit eshte data 01.12.2027.

Neni 10

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare "**HAK Food**" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES:

Bekim Darsi

Atnan Spahi

Tiranë, më datë 02.12.2022